



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA LEZHË  
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 284 Prot

Lezhë, më 02 / 03 /2026

VENDIM

Nr. 21, Datë 25. 02. 2026

PËR NGRITJEN E KËSHILLIT ARTISTIKO-KULTUROR DHE TURISTIK NË  
BASHKINË LEZHË

Në zbatim të Ligjit Nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” neni 8, neni 9 pika 1.1, Neni 25, të Ligjit nr.10352, datë 18.11.2010 “Për Artin dhe Kulturën”, të VKM Nr.121, datë 25.02.2005 “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr.540, datë 21.12.1992 “Për krijimin e Këshillave Artistiko-Kulturore”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë dhe pas diskutimit, Këshilli i Bashkisë Lezhë;

Vendosi:

1. Miratimin e Këshillit Artistiko-Kulturor dhe Turistik pranë Bashkisë Lezhë, të përbërë nga 5 anëtarë.
2. Mandati i Këshillit Artistiko-Kulturor dhe Turistik do të jetë 2 vjet.
3. Anëtarët e Këshillit Artistiko-Kulturor dhe Turistik do të paguhen me një shpërblim prej 4 500 (katër mijë e pesëqind) lekësh për çdo mbledhje, por jo më shumë se 6 mbledhje në vit.
4. Burimi i financimit do të jetë buxheti i Bashkisë Lezhë.
5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
6. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikë 6, të nenit 55, të ligjit Nr. 139/ 2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, të ndryshuar.

SEKRETARI  
FLORIDA ÇUNAJ

KRYETARI  
NDUE LULI





Nr. 281/1 prot  
K.B Dt: 11.3.26

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PREFEKTI I QARKUT LEZHË  
SEKTORI JURIDIK

Nr. 212/18 Prot.

Lezhë, më 10.03.2026

**Lënda: Konfirmim vendimi**

**KËSHILLIT TË BASHKISË LEZHË**

**Për Dijeni: KRYETARIT TË BASHKISË LEZHË**

Bazuar në nenin 16 pika 2 gërma "b" të ligjit Nr.107/2016, datë 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", nenin 54 të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" të ndryshuar, ligjin nr .10352, datë 18.11.2020 "Për artin dhe kulturën", VKM-në nr.540, datë 21.12.1992 "Për krijimin e këshillave artistiko-kulturore dhe shpërblimin e anëtarëve të tyre", të ndryshuar konfirmoj bazueshmërinë ligjore të vendimit nr.21, datë 25.02.2026 të Këshillit të Bashkisë Lezhë "Për ngritjen e Këshillit Artistiko-Kulturor dhe Turistik, në bashkinë Lezhë".

**PREFEKTI**

**Taulant MALSHI**

